



Komuna e Klinës  
Kryetari i Komunës

01Nr 500-13342 /2020

Klinë, dt.19.06.2020

*Duke u bazuar në nenin 13, 17 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, botuar në gazetën zyrtare nr. 28/2008 të publikuar me dt.04.06.2008, nenin 91 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Klinës të dt. 07.04.2010, si dhe duke marrë parasysh vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.02/06 të datës 17.06.2020, më rekomandimin e Shtabit emergjent, Kryetari i Komunës së Klinës, më dt. 19.06.2020, merr;*

## V E N D I M

1. **OBLIGOHEN**, të gjitha institucionet publike dhe private në Komunën e Klinës, që në mënyre rigoroze të respektojnë masat mbrojtëse nga përhapja e COVID-19, në përputhje me vendimet e QRK-së dhe Manualin e MSH për Mbrojtje nga Përhapja e Virusit COVID-19.
2. **NDALOHET**, hyrja në objektin e administratës të Komunës së Klinës dhe institucioneve vartëse të saj pa masa mbrojtëse, përkatësisht **maska**.
3. **Obligohet** inspektorati komunal që në bashkëpunim me Policinë e Kosovës të veproj në përputhje me autorizimet ligjore, më qellim të respektimit të masave.
4. **Obligohet** shërbimi i sigurimit- rojave që në hyrje të objektit të Komunës së Klinës si dhe objekteve tjera publike mos lejoj hyrjen e asnjë person pa maskë.
5. Ky vendim është i plotfuqishëm dhe do të zbatohet menjëherë.

### Te njoftohet:

- Ueb faqen zyrtare;
- Drejtoria e Inspektoratit;
- Drejtoritë komunale;
- Policia e Kosovës- Klinë;
- Arkivi.

Kryetari,  
**Zenun Elezaj**





Opština Klina  
Predsednik Opštine  
01Br.500-13342 / 2020  
Klina, dt.19.06.2020

Na osnovi članaka 13, 17 i 58 Zakona 03/L-040 LSU, objavljen Službeji List broj 28/2008 dana dt.04.06.2008 na osnovi člana 91, stav 1 Statuta Opštine Klina datuma 07.04.2010, kao i na osnovi odluke Vlade Republike Kosova broj 02/06 dana 17.06.2020, i uz preporuke Kriznog Staba, Predsednik Opštine Klina, dana 19.06.2020 uzima sledeću

## ODLUKU

1. **OBAVEZUJU** se sve javne i privatne institucije u opštini Klina da striktno postuju zastitne mere protiv prosirenja COVID-19 u skladu sa odlukama VRK i Manuala MZ za Zastitu od prosirenja virusa COVID-19.
2. **ZABRANJUJE** se ulazak u zgradu Opštine Klina i ostalim institucijama iste bez zastitnih mera, odnosno maske.
3. Obavezuje se opštinski inspektorat da u saradnji sa Policijom Kosovo deluje u skladu sa zakonskim ovlacenjima u cilju postovanja mera.
4. Obavezuje se sluzba siguranja-cuvari da na ulazu zgrade Opštine Klina kao i ostalim javnim zgradama ne dozvoljavaju ulazak lica bez maske.
5. Odluka je punovazna i stupa na snazi odmah.

### Obavestavaju se:

- Javna internet stranica Opštine;
- Odeljenje Inspektorata;
- Opštinske odeljenja;
- Policija Kosova - Klina;
- Arhiva.

Predsednik,  
Zenun Elezaj

